



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 180, datë 29.09.2023**

**PËR  
LICENCIMIN E SUBJEKTIT “IUTEPAY” SH.P.K., PËR USHTRIMIN E  
VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME, NË KLASAT E JETËS,  
NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “INSIG JETË” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, në bazë të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe bazuar në rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Licencimin e subjektit “IutePay” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Insig Jetë” sh.a.**
- 2. Miratimin e z. Ervin Peçuni, zj. Bealba Mata dhe zj. Fabiola Seiti për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jetës, në emër dhe për llogari të subjektit “IutePay” sh.p.k.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**